



*Dr. Ilir Muharremi*

### POSTMODERNIZMI DHE ARTI KONCEPTUAL

Qëllimi i artit është të shpërfaq emocione të brendësisë, nuancat e drejtpërdrejta shpirtërore, dhe të objektivizohet në kolektiv ku duhet të zgjohet diskutimi për këtë lloj prezantimi. Nëse kemi të bëjmë për artin e sotëm nëpër botë, lirisht mund të pohojmë se ndodh një përzierje, ballafaqim rrymash të ndryshme të cilat njëkohësisht globalizojnë të dukshmen, pa dukshmen, ekonominë, politikën, shkencën dhe shumë sfera të tjera që preokupojnë botën. Lirisht mund të thuhet se është një këndvështrim më i gjerë, më jetë gjatë, më subjektiv aspak përmbysës i së kaluarës duke filluar nga ajo primitivja, mesjeta, rilindja, modernia, post modernia, konceptualja... Tek arti postmodern e veçanta është e parezantueshmja të prezantohet të hidhet poshtë çdo rregull, jo për hir të kënaqësisë, përjetimit të formave, ngjyrave, por për të treguar se ekziston e pamundura e cila përmes prezantimit bëhet e mundur. Artisti Anselm Kiefer njëzet e pesë vitet e fundit veprat e tija janë ekspozuar thuajse në gjithë Evropën, në SHBA dhe Japoni. Ai ka krijuar shumë vepra dhe vlen të veçohet një pikturë metafizike duke u përballur me një temë që në Gjermani shumë njerëz, deri në vitet '60 dhe '70, do të dëshironin ta harronin, por që Kieferin u bë thuajse imperativë; historinë gjermane gjatë periudhës naziste. Ai shkaktoi diskutime, skandale të cilët zgjatë plot pesëdhjetë vjet. Më 1969, njëzetekatërvjeçar në atë kohë, u prezantua në skenën artistike ndërkombëtare me një seri fotografish të titulluara thjesht "Pushtime", në të cilat ai tregonte veten, duke nderuar si nazist, në vendet e pushtuara nga Hitleri gjatë luftës së dytë botërore. Ai tallej me Fyhrerin.

Shumë krijues konceptual tek ne, në Kosovë, zhyten në ujërat e artit konceptual, duke gjetur diçka brenda modernes dhe prezantuar të pamundurën. Që të manipulosh me idenë, ose të eksperimentosh me konceptin, duhet ta kopjosh saktë objektivizmin në pëlhurë, të jesh maestro i realizmit të tij, e tek pastaj të fshihesh prapa perdes së konceptualizmit.

Nga lashtësia janë shpalosur vepra të mrekullueshme arti, të pa harruara, të thelluara, dhe të shënuara në kohë. Veprat e bukura arti datojnë që nga pikturat në varret e egiptianëve, deri tek dekoracionet e Pallatit të Minoas. Pjesa më e madhe e artit të lashtësisë bëhej për qëllime ritualesh. Në shek katërbëdhjetë, ishte paksa më ndryshe, arti kufizohej nga kishat dhe godinat të tjera fetare-piktura shenjtorësh, apo histori të biblës.

Dikush mund të pohon se ato pak piktura të pavarura për këndë krijoheshin?! Përgjigja më e saktë është kjo: Për individë të ndryshëm që po ashtu kishin tendencë fetare. Ndërsa, në kohën e impresionizmit konkretisht në shekullin nëntëmbëdhjetë natyra e qetë iu largua ngjashmërisë me realitetin, pasi artistët filluan të eksperimentojnë me të, për të shprehur ndjenjat e tyre. Impresionizmi, si lëvizje është frymëzuar nga një pikturë e piktorit të famshëm Claude Monet. Në këtë pikturë luhej me dritën, në ç' mënyrë?

Drita shfaqej në pikturë në të gjithë 'faqet' e saj , përpiquej të paraqiste mënyrën se si ndryshonte ajo , pamje të ndryshme të saj , por të paraqitura në një pikturë. Estetika, përjetimi, ngacmimi, jetëgjatësia e artit rruhet thellë në folenë e impresionizmit. Impresionizmi ka hulumtuar tema e gjëra si dritën dhe lëvizjen me të cilat edhe është distancuar nga arti realist. Mirëpo, çfarë ndodh tek Postmodernizmi, që njihet si art mjaftë revolucionar dhe në fakt postmodernizmi nuk qëndron pas modernizmit, apo kundër tij, ai gjendet i fshehur dhe brenda tij.

Një shkrimtar apo piktor postmodernist ndodhet në pozicionin e një filozofi, dhe ngjyrat të cilat ai i gjuan në pëlhurë, apo tekstet të cilat i udhëheq shkrimtari, nuk udhëhiqen nga rregulla paraprake. Nga kjo na del se artisti apo shkrimtari punon pa përfillur rregulla dhe për të vendosur rregullat e asaj që do të krijohet. Veprat lindin më shpejt se rregullat, i tejkalojnë rregullat apo i paraprijnë ato. Postmodernistët nuk krijojnë realitet , por aluzione të konceptueshme që vështirë paraqiten. Termi "postmodernizëm" daton qysh në vitin 1926 dhe shfaqet qysh në vitet e 1870-ta, kur u pat përdorur nga artisti britanik John Ëatkins Chapman.

Nëse flitet për artin tonë pamor apo letërsinë, të cilat marrëzisht, dhe maksimalisht janë zhytur në shabllone dhe rregulla, qëndrojnë në distancë shekullore ndaj postmodernizmit. Ndoshta, mund të ekzistojë një art postmodern, por jo një njeri

postmodern, sepse ende mbetet diçka primitive te ai. Edhe pse shumë artistë tentojnë që veten ta identifikojnë si postmodernistë përmes punës, mungon ai mendimi filozofik që i hedhë poshtë rregullat. Ose çfarë ndodh me artin konceptual?! A e praktikojmë ashtu si duhet praktikuar, apo jetojmë vetëm në iluzionin për ta kuptuar. Ky art u paraqit në vitet e '60 dhe ka grupuar artistë të ardhur nga drejtime të ndryshme.

Katerin Mile shkruan: “Arti konceptual nuk nënkupton reduktimin e veprës në një ide, por vetë idenë e artit, konceptin e artit”. Arti konceptual përfshin metoda dhe forma të ndryshme artistike duke u nisur nga performansa, instilacioni etj. Gjithnjë artistët të cilët zhyten në këtë art, janë në dijeni se vepra të cilën e krijojnë i nënshtrohet idesë ose filtrimit. Duhet të jetë e arsyeshme e plotësuar.

Sol Leëitt shkruan: “Artisti nuk mund ta parafytyroj artin e tij. Ai nuk mund ta perceptojë atë përderisa ai nuk është plotësuar”. Plotësimi luan rol të madh ndaj perceptimit, sepse nëse nuk plotësohet nuk mund të perceptohet esenca. Shumë krijues konceptual tek ne në Kosovë, zhyten në ujërat e artit konceptual, duke mos njohur mirë rregullin: “Realizmin”.

Që të manipulosh me idenë, ose të eksperimentosh me konceptin, duhet ta kopjosh saktë objektvizmin në pëlhurë, të jesh maestro i realizmit të tij, e tek pastaj të fshihesh prapa perdes së konceptualizmit. E lehtë është që të fshihesh, pa anashkaluar tek zanafilla, mirëpo herë do kurdo defekti to jetë i gjallë, si një llavë vullkanike.

---

Aventurat e artit të shek XX – Carpe Diem 2004” – Tiranë, fq:232

Lazar Trifunovic, “Slikarski pravci XX veka’ – Beograd, 1994, fq:27

Rosie Dickins & Mari Griffith, “Njohuri për artin në bashkëpunim me Galerinë Kombëtare të Londrës”, Tiranë, 2004, fq:6

PR  
DIOGEN pro kultura  
<http://www.diogenpro.com>